

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Drejtor	Reparti Ushtarak nr.6028, AIM	Tiranë	Pa afat	Po	Po	27.02.2025	13.03.2025
2								

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Drejtor i Inspektimit
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Drejtoria e Inspektimit, në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes.Reparti Ushtarak Nr.6028,
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 27.02.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 13.03.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- | | |
|-------------------------|---|
| a. Grada/Titulli: | Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit. |
| Arsimi : | I lartë universitar "Master Shkencor" me 120 kredite sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Drejtësi edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. |
| b. Kualifikimi: | Në fushën e lartëpërmendur. |
| c. Trajnimi: | Trajnime në fushën që lidhet me inspektimet. |
| d. Eksperienca në Punë: | Të këtë minimalisht 5 vjet eksperiencë në institucione të administratës publikeku të ketë punuar në dy ose më shumë nga këto fusha: procese pune që lidhen me inspektimin dhe mbikëqyrjen; përvojë në zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e procedurave të inspektimit dhe mbikëqyrjes, përfshirë monitorimin |

e. Gjuha e huaj: f. Kërkesa të tjera specifike: g. Niveli i certifikatës së sigurisë: sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.	e përputhshmërisë me ligjet dhe aktet nënligjore: procese pune që lidhen me kryerjen e hetimeve administrative Njohuri të mira të gjuhës Anglisht. Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve kryesore të kompjuterit. “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.
Përshkrimi i punës: Detyrat kryesore: ➤ Harton planin e inspektimeve dhe e paraqet për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm. ➤ Merr masa për realizimin e planit të inspektimeve nga grupet e Inspektimit. ➤ I paraqet kërkesa drejtorit të Përgjithshëm për plotësimin e grupit të Inspektimit me ekspertë të fushave të tjera nga brenda dhe jashtë institucionit. ➤ Mbikëqyr kryerjen dhe zbatimin e procedurave të inspektimit tek subjektet e licencuara. ➤ Së bashku me grupin e inspektimit kryen inspektime në vendin e prodhimit me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve teknike dhe operacionale, para lëshimit të licencës së prodhimit. ➤ Kryen inspektime të rregullta dhe monitoron aktivitetet e subjekteve të licencuara për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin, veçanërisht me kërkesat e sigurisë e të cilësisë. ➤ Kryen inspektime të rregullta, me dhe pa paralajmërim, në subjektet e licencuara për të vërtetuar përputhshmërinë me legjislacionin, rregulloret dhe standardet e sigurisë e të mjedisit sipas planit të miratuar. ➤ Përgatit raportin e inspektimit dhe ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm për miratim.	Misioni i Drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit në AIM është të udhëheqë dhe të mbikëqyrë aktivitetin e inspektimit me qëllim zbatimin e legjislacionit në fushën e industrisë ushtarak si dhe qëllimi i përgjithshëm është të mbikëqyr, drejtojë dhe koordinojë procesin e inspektimit në mënyrë që industria e mbrojtjes të funksionojë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: ▪ përzgjedhjen paraprake; ▪ vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; ▪ intervistën e strukturuar me gojë. Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i	

plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilin profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilin profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.